



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Nr. 01/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti i mbledhjes së 28 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, Plani i Veprimit për Partneritet Evropian 2008 dhe strukturat që kanë për qëllim monitorimin/zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian.
2. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian 2008 të rishikohet dhe harmonizohet me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2008-2011 dhe planifikimet buxhetore për të njëjtën periudhë.
3. Ngarkohet Agjencia për Integrim Evropian në Zyrën e Kryeministrit për inkorporimin e vërejtjeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Agjencia për Integrim Evropian në Zyrën e Kryeministrit, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe ministrinë - institucionet tjera relevante.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit më Qenie Njerëzore 2008-2011.
2. Obligohen të gjitha ministritë e përfshira në Strategji për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të bëhet pagesa e mëditjeve shtesë në shumë prej 60 Euro, për seancat e mbajtura e që nuk janë paguar për muajt; tetor, nëntor dhe dhjetor 2007, për anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor.
2. Mjetet financiare sigurohen nga ndarjet buxhetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 05/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Deri në hartimin dhe aprovimin e studimit "Përgatitja e procesit për tenderimin e ndërtimit të hidrocentraleve të vogla-procedurat", asnjë zyrtar në nivel qendror dhe komunal nuk ka të drejtë të ndërmarrë çfarëdo veprimi administrativ që mund të paragjykojë dhënien e lejes për fillimin e veprimeve me qëllim të ndërtimit të hidrocentraleve të vogla me kapital privat.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Energjisë dhe Minierave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, organet përgjegjëse në komunat e Kosovës, si dhe të gjithë organizmat tjerë relevantë të sektorit të energjisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THACI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet urdhri i përkohshëm i propozuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave për zbatimin e procedurave të shkyçjes dhe ri-kyçjes së konsumatorëve të energjisë elektrike.
2. Obligohet Ministria e Energjisë dhe Minierave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të Kapitullit VI, nenit 92, pika 4 dhe nenit 93 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, shtojcës IX, pika i,ii,iii, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/53, nenit 7, pika 8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/13, mbi miratimin e buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, si dhe nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

Për miratimin e shtesave në paga, për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës

Me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve në të gjitha organizatat buxhetore, të stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare, njëtrajtshmërisë së shtesave ekzistues, dhe me qëllim të zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë me vlerë të njëjtë, të gjitha organizatat buxhetore të Republikës së Kosovës duhet të ndërmarrin masa si më poshtë:

1. Të gjitha organizatat buxhetore propozimet për shtesa në paga për kategori të veçanta deficitare dhe për punonjës të veçantë i bëjnë në Ministrinë e Shërbimeve Publike/DASHC.
2. Propozimet lidhur me shtesat në paga për ruajtjen e punonjësve iniciohen nga zyrtari kryesor administrativ i organizatës buxhetore përkatëse në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ministria e Shërbimeve Publike në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave përgatit listën dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të shtesave në paga, duke përfshirë edhe shumën për këto pozita, në afat prej 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


4. Pavarësisht nga pozita, paga bazë së bashku me shtesat në paga nuk mund të tejkalojë pagën e zyrtarëve të lartë publik të emëruar nga KELP-i.
5. Ministria e Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, i rekomandon Qeverisë dhe pas miratimit nga Qeveria nxirret lista dhe standardet kualifikuese dhe shuma e shtesës në paga për postet e caktuara deficitare e cila do të aplikohet në mënyrë unike në të gjitha organizatat buxhetore që kanë të punësuar kategoritë e tilla të punonjësve.
6. Ministria e Shërbimeve Publike, në konsultim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, shqyrton kohë pas kohe listën dhe standardet kualifikuese dhe shumën e masës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjashtë muaj.
7. Ministria e Shërbimeve Publike/DASHC nuk do të procedojë për ekzekutim në sistemin e pagave asnjë vendim për aprovim të shtesave në paga, nëse paraprakisht kërkesat për shtesa nuk janë shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.
8. MSHP/DASHC nuk do të procedojë për ekzekutim në sistemin e pagave asnjë nivel të pagës, e cila nuk është parashikuar me ligjin në fuqi.
9. Shtesat në paga do të paguhen nga shpenzimet e autorizuara për “paga dhe rroga”.
10. Ngarkohet Ministria e Shërbimeve Publikë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
11. Obligohen të gjitha organizatat buxhetore të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij vendimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

12. Ky vendim nuk ka të bëjë me procedurat e parapara me nenin 7.8 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2008/13 mbi miratimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe shpenzimeve të autorizuara për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008.

13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/29

Datë: 31.07.2008

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2008, mori

V E N D I M

1. Objekti i Institutit të Historisë kalon në shfrytëzim të Bibliotekës Universitare të Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë